



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 6422/1 Prot.

Tiranë, më 07 .12 .2022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 6422/1, datë 07 .12 .2022

PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “ALBAFILM” SH.A

Në mbështetje të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 09.09.2020 “Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Albafilm” sh.a, Tiranë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Kulturës”, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të Statutit të shoqërisë “Albafilm” sh.a, si dhe vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 547, datë 18.08.2022 “Për përgatitjen e dokumentacionit të zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë “Albafilm” sh.a Tiranë”,

VENDOSI:

1. Kapital themeltar të zvogëlohet për vlerën 10,825,000 (dhjetëmilion e tetëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, i barabartë me 10,825 (dhjetëmijë e tetëqind e njëzet e pesë) aksione, me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) lekë.
 2. Kapitali aksionar i shoqërisë ishte 895,701,000 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e një mijë) lekë bëhet 884,876,000 (tetëqind e tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.
 3. Numri i aksioneve ishte 895,701 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e një) aksione, bëhet 884,876 (tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) aksione.
 4. Kapitali i shlyer ishte 902,320,000 (nëntëqind e dy milion e treqind e njëzet mijë) lekë, bëhet 884,876,000 (tetëqind e tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.
 5. Ngarkohen Administratori i shoqërisë “Albafilm” sh.a për njoftimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit për zvogëlimin e kapitalit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

